

Vendim nr. 208 datë 28.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 28.07.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 21 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BARDHYL IBRA**

OBJEKTI: **Kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 126, datë 22.05.2025 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 11, pikat 3 dhe 4, 18, pika 1, shkronja “c” dhe 25, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi në datën 25.03.2025 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, me objekt: “*Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4331, datë 31.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i gjykimit të çështjes nga një gjykatë jokompetente, për shkak të konflikteve të herëpashershme me gjyqtaren A.A. të Gjykatës së Lartë. Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda*

afatit të arsyeshëm, të parashikuar nga pika 2 e nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, të kërkesës nr. regjistrimi 31146-01765-86-2020, datë 23.07.2020, pranë sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit dhe përshpejtimi i shqyrtimit të çështjes. Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit nga Gjykata e Lartë, brenda afatit ligjor 45-ditor të përcaktuar nga neni 399/7, pika 2, i Kodit të Procedurës Civile, të kërkesës së regjistruar në atë gjykatë me nr. 77105-00108-00-2024”.

2. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 126, datë 22.05.2025 (vendimi nr. 126/2025), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se në lidhje me kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument se vonesa në shqyrtimin e çështjes i ka sjellë pasoja të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale për t’i dhënë prioritet gjyqimit të saj nga Gjykata Administrative e Apelit, ndaj nuk duket që gjykimi i çështjes të ketë tejzgjatje të paarsyeshme në aspektin kushtetues.

3. Në datën 24.06.2025 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

4. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi në Kolegjin që ka shqyrtuar çështjen e tij në Gjykatë ka marrë pjesë edhe gjyqtari I.T. me të cilën ai ka mosmarrëveshje në kuptim të nenit 72 të KPC-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

5. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës parashikon se pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj. Ndërkohë, neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet shqyrtimit paraprak nga Kolegji i Gjykatës, i cili vlerëson nëse ankimi përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji për kalimin e çështjes në seancë plenare. Ky ligj dhe Rregullorja e Gjykatës kanë parashikuar më tej rregullat e detajuara të procedurave të gjyqimit kushtetues, duke parashikuar në dispozita të posaçme edhe kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjyqimit kushtetues. Ky parashikim është

detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimet e Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohen, por veçse mund të saktësohen, plotësohen ose ndreqen për gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në to.

6. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se kërkesa ka në objektin e saj rishikimin e vendimit nr. 126/2025 të dhënë nga një Kolegj tjetër i Gjykatës gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës. Me anë të këtij vendimi është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte plotësuar një nga kriteret e pranueshmërisë për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Pas dhënies së vendimit nr. 126/2025 të Kolegjit dhe marrjes dijeni për të, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës, duke kërkuar rishikimin e tij, me pretendimin se me njërin nga anëtarët e trupit gjykues të atij Kolegji ka mosmarrëveshje në kuptim të nenit 72 të KPC-së.

7. Kolegji thekson se vendimi i Kolegjit të Gjykatës, i dhënë në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesës, ka natyrë përfundimtare (*res judicata*) për efekt të procesit gjyqësor kushtetues dhe nuk mund të vihet në diskutim ose të bëhet objekt kontrolli as nga vetë Gjykata, përveç rastit të parashikuar në nenin 71/c të ligjit nr. 8577/2000, kur një gjykatë ndërkombëtare, juridiksioni i së cilës shtrihet ndaj shtetit shqiptar, ka konstatuar cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit si rrjedhojë e atij vendimi të Kolegjit të Gjykatës. Nën dritën e dispozitave të analizuara më lart, Kolegji çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Bardhyl Ibra, sipas objektit të mësipërm, nuk mund të merret në shqyrtim.

8. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.